



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.848/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T.SH. “Borovci Petrol” me NRB: 71068099, me seli në Kamenicë, kundër debitorit “ADA GAS” SH.P.K., me NRB: 71068099, me seli në Gjilan, Rruga “Metush Krasniqi” p.n., duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.756/22 të datës 25.01.2024, me datë 30.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e debitorit “ADA GAS” SH.P.K., me NRB: 71068099, me seli në Gjilan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.756/22 i datës 25.01.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.756/22 të datës 25.01.2024 e ka hedhur si jo të plotë prapësimin e debitorit “ADA GAS” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.316/21 të datës 13.12.2021 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Përparim Xhelili.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e debitorit, ashtu që aktvendimi i atakuar të priset dhe lënda t'i kthehet shkallës së parë në rigjykim.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.T.SH. “Borovci Petrol” me seli në Kamenicë, ka lëshuar Urdhrin për përbarim P.nr.316/21 të datës 13.12.2021, në bazë të dokumentit përbarues Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike me numër V.Ek.nr.51/2019 i datës 25.05.2021, i plotfuqishëm nga data 10.11.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 02.12.2021, me të cilin është detyruar debitori që në emër kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguajë kreditorit shumën prej 2,335.00 Euro, taksën gjyqësore në shumë prej 57.00 Euro, për përpilimin e propozimit shumën prej 156.00 Euro, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, dhe të gjitha këto detyrime të realizohen përmes zbatimit të përbarimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare të kreditorit, dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përbarimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të autorizuarit të kreditorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përbarimit, me datë 17.12.2021, prapësim ka paraqitur debitori “ADA GAS” Sh.P.K., ndërsa me datën 22.12.2021, përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori N.T.SH. “Borovci Petrol”.

Gjykata Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.756/22 të datës 25.01.2024 e ka hedhur si jo të plotë prapësimin e debitorit “ADA GAS” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.316/21 të datës 13.12.2021 të lejuar nga Përmbarruesi Privat Përparim Xhelili.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se prapësimi i debitorit është jo i plotë për shkak se parashtruesi i prapësimit nuk ka dorëzuar autorizimin e nënshkruar nga debitori për përfaqësim si dhe nuk është plotësuar- nuk ka dorëzuar të njëjtin as pas pranimit të konkluzionit, andaj në mbështetje të nenit 73.3 të LPPsë, me të cilën përcaktohet se “ *Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar*”, gjykata e ka hedhur poshtë prapësimin si jo të plotë, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka hedhur si jo të plotë prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës, përkatësisht nga Konkluzioni KPPP.nr.756/22 i datës 19.05.202023 i lëshuar nga gjykata e shkallës së parë, qartë konstatohet fakti se kjo gjykatë e ka urdhëruar parashtruesin e prapësimit që në afat prej 3 (tre) ditësh pas pranimit të konkluzionit, ta plotësoj prapësimin e datës 17.12.2021, dhe t’ia sjell gjykatës autorizimin origjinal, të nënshkruar dhe vulosur nga debitori për paraqitjen e prapësimit dhe përfaqësim në këtë çështje përmbarrimore, mirëpo nga fletë kthesa rezulton se konkluzionin e ka pranuar me datë 06.12.2023, ndërsa deri në ditën e marrjes së këtij aktvendimi nuk e ka kryer obligimin sipas konkluzionit.

Duke pasur parasysh faktin se parashtruesi i prapësimit nuk e ka sjell autorizimin origjinal, të nënshkruar dhe vulosur nga debitori, edhe kjo gjykatë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe në mbështetje të nenit 179.2 të LPK-së, i cili përcakton se “*Po që se ankuesi brenda afatit nga paragrafi 1 i këtij neni nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, gjykata me aktvendim e hedhë poshtë ankesën si jo të plotë*”.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por të njëjtat mbesin të pabazuara pasi nuk ka arritur t'i argumentoj me prova juridikisht të vlefshme, ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP-së dhe si të tilla i refuzoi ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoi.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.848/24 me datë 30.12.2024

Gjyqtari

Krenar Berisha